

THIRRJE PËR OFERTA

51/SiV/2023 – Konfigurimi dhe instalimi Server-it për organizatën Syri i Vizionit

Termet e referencës

Mars 2023

Afati i fundit për ofertat: 17 Mars 2022

Hyrje

Organizata Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në Shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë më herët që nga 1999 si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Përgjatë viteve të fundit, OJQ "Syri i Vizionit" ka zhvilluar partneritete të shumta me një spektër të gjerë të organizatave lokale dhe ndërkombëtare, komunave dhe faktorëve tjerë aktivë në Kosovë dhe rajon si: Komisioni Evropian, Save the Children në Kosovë, Olof Palme International Centre, Solidar Suisse, Volkshilfe Solidaritet, ADA, USAID, KEC, KFOS, DRC, CARE International, OSCE, etj.

SiV në bashkëpunim me Save the Children, në kuadër të programit tematik në fushën e mbrojtjes së fëmijës, parasheh edhe zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve humane e logjistike të organizatës.

Objektiva

Syri i Vizionit po kërkon një kompani apo ekspert për instalimin e serverit, i cili do lehtësoj punën e përditshme të stafit të organizatës, pajisja - serveri se bashku me sistemin operativ (Windows server 2022) gjinden në zyrat e organizatës.

"Syri i Vizionit" në pajtim me përshkrimin dhe nevojat e projektit, shpall këtë tender për instalimin e një Serveri me detalet e me poshtme:

- Instalimi i Windows Server 2022, konfigurimi dhe testimi i serverit, rrjetit dhe hapësirës për ruajtjen e te dhënave që të bëjë te mundur punën e stafit me te lehte dhe me efektive.

Dokumentet e nevojshme:

- Për Biznese: Certifikata e biznesit dhe numri fiskal
- Për Individ: CV dhe letër njoftimi
- Oferta financiare

Ofertat:

Të gjitha ofertat duhet të dorëzohen në letër ose me email jo më vonë se më 17 Mars 2023 në zyrën e “Syri i Vizionit”, ose me email office@syriivizionit.org,

Adresa: ISA DEMAJ, 14, 30000 Pejë, Kosovë.